



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; Web-site www.klsh.org.al

Nr. 1004/5 Prot.

Tiranë, më 14.12.2018

V E N D I M

Nr. 189, Datë 14.12.2018

**PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË KËSHILLIN E QARKUT TIRANË “MBI
AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” PËR
PERIUdhËN NGA 01.01.2016 DERI MË DATËN 30.09.2018.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë, të ushtruar në Këshillin e Qarkut Tiranë, sipas programit të auditimit nr. 1004/1 prot, datë 7.09.2018 për veprimtarinë nga data 01.01.2016. deri më datën 30.09.2018.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

OPINIONI i AUDITIMIT

I. Opinion i pa kualifikuar mbi pasqyrat financiare.

Ne kemi audituar veprimtarinë e subjektit “Këshilli i Qarkut Tiranë” për vitin ushtrimorë nga 1 Janar 2017 deri më 31 Dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar (*hyrjeve dhe daljeve, pagesave*) në para, pasqyra e amortizimit, shënimet shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, përsa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Këshilli i Qarkut Tiranë Tiranë, të standardeve dhe ligjit të kontabilitetit mbi pasqyrat financiare, në përgjithësi japin një pamje të drejtë dhe të sigurtë të pozicionit financiar të performancën financiare dhe lëvizjet e mjeteve monetare për Këshilli i Qarkut Tiranë më 31.12.2017, kjo referuar Ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave “Për procedurat e përgatitjes dhe mbylljes së pasqyrave financiare për institucionet qendrore, njësitë e qeverisjes vendore, njësitë e tyre të varësisë dhe njësitë e zbatimit/implementimit të projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë huaj”, përveç aspekteve që adresohen në bazën për theksim të çështjes, duke përjashtuar disa anomali në plotësimin e tyre në zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi, për dhënien e **një opinionit të pa kualifikuar**”, konkretisht.

-Llogaria “Studime dhe Kërkime”, llogaria aktive e bilancit me vlerë 10,526,377 lekë përbëhet nga studime të financuara në vite. Konstatohet se administrimi e projekteve dhe studimeve të investuara, nuk është bërë ndonjëherë inventarizimin fizik i tyre paraqitur në bilancin e vitit 2017.

- Llogaria “Ndërtime dhe konstruksione” llogari aktive e bilancit të vitit 2017 me vlerë prej 33,233,361 lekë, këto aktive janë krijuar që nga viti 2000 sipas procesverbalit datë 09.10.2000 të marrë nga Këshilli Rrethit Tiranë dhe shtesa të tjera të analizuara, por këto aktive nuk janë të regjistruara në ZVRPP, Tiranë (hipotekë), ndërsa inventarizimi i tyre është bërë sipas kontabilitetit, për të dy rastet veprimet vijnë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, neni 7, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III pikat 26, 35/b, 35/c dhe kap IV, pika 73 dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kap. II, pika 1.

II. Opinionin mbi përputhshmërinë për të ardhurat dhe procedurat e prokurimeve në Këshillin e Qarkut Tiranë.

- Opinion i pa kualifikuar në fushën procedurave të prokurimit.

Ne kemi audituar përputhshmërinë e subjektit me ligjet dhe rregulloret në lidhje me realizimin e procedurave të prokurimit për shërbime/ blerje malli vjetore të buxhetit, nga ana e Këshilli të Qarkut Tiranë. Në opinionin tonë, për shkak të rëndësisë së çështjeve të përmendura në bazën për opinionin e përputhshmërisë, procedurat e prokurimeve kanë qenë në përgjithësi në përputhje me kuadrin ligjor financiar në fuqi, për të cilën japim **opinion të pa kualifikuar**”.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standarteve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Ministria e

Financave dhe Ekonomisë, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-*Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë* e SAI-t, si dhe ISSAI 30-*Kodi Etik*, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Këshillit të Qarkut Tiranë.

Drejtimi i të Këshillit të Qarkut Tiranë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, me ndryshime dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve Shtetërorë të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare.

Objekivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH gjithashtu aplikon gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje: Nga ana e Titullarit të Këshillit të Qarkut Tiranë, nuk janë nxjerrë urdhra me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit.

Grupi i Menaxhimit Strategjik në Këshillin e Qarkut Tiranë, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjikë me afat jo më pak se sa 5 vjet, kërkesë e nenit 32 të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (*Më hollësisht trajtuar në pikën A në faqet 15-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandime: Të merren masa nga Titullari i Këshillit të Qarkut Tiranë, për nxjerrjen e urdhrave me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit.

Grupi i Menaxhimit Strategjik në Këshillin e Qarkut Tiranë, të miratojë plane zhvillimi strategjikë me afat jo më pak se sa 5 vjet, bazuar në kërkesën e nenit 32 të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Brenda 3-mujorit të parë të vitit 2019

2. Gjetje: Për vitin 2017, buxheti i Këshillit të Qarkut Tiranë është miratuar me VKB (Q)-në nr. 37, datë 12.02.2017. Në total, treguesit e buxhetit, janë programuar 123,877 mijë lekë, realizuar 74,586 mijë lekë ose 60.2 %.

Investimet janë programuar 65,830 mijë lekë, realizuar në masën 48,521 mijë lekë ose 73.7%. Mos realizimi i investimeve ka ardhur kryesisht pasi Ministria e Financave me shkresën nr. 15973 prot, datë 09.11.2017 “Mbi limitin e përdorimit të cash-it për njësitë e vetëqeverisjes vendore” ka limituar përdorimin e fondeve për këtë vit.

Në programimin dhe zbatimin e buxhetit, u konstatuan këto shkelje ligjore:

-Nuk janë miratuar nga Këshilli i Qarkut, treguesit faktik të realizimit të buxhetit në periudha 3, 6 dhe 9 mujore, në kundërshtim me kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2006 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

-Për vitin 2018, buxheti i Këshillit Qarkut është miratuar me VKB (Q) nr. 59, datë 23.12.2017.

Në total, treguesit e buxhetit, janë programuar 111,976 mijë lekë, realizuar për periudhën 9 mujore për 55,539 mijë lekë ose 56.3%.

Investimet janë programuar 42,827 mijë lekë, realizuar për periudhën 9 mujore në masën 32,444 mijë lekë ose 75 % (Më hollësisht trajtuar në pikën A në faqet 18-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Tiranë, të marrë masat për përgatitjen e një buxheti sa më real, me qëllim që të gjitha investimet e programuara, të realizohen sipas afateve të parashikuara në treguesit e buxhetit.

Në zbatimin e buxhetit, të procedohet sipas kërkesave ligjore duke analizuar në Këshillin e Qarkut, realizimin e tregueseve faktikë të tij në periudha 3 mujore dhe në fund të vitit ushtrimor duke nxjerrë më parë përgjegjësitë për mangësitë e konstatuara.

Menjëherë e vazhdimisht

3.Gjetje: - Llog: 202 - Studime dhe Kërkime, llogaria aktive e bilancit me vlerë 10,526,377 lekë përbëhet nga studime të financuara në vite. Nga auditimi u konstatua se administrimi e projekteve dhe studimeve të investuara, nuk është bërë inventarizimi fizik i tyre në kundërshtim me kërkesat e kërkesat e nenit 7 të ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, pikat 26, 35/b, 35/c kap. III dhe pika 73, kap IV të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe pika 1, Kap. II e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël” (Më hollësisht trajtuar në pikën A në faqet 16-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Të merren masat, të verifikohet saktësia e llogarisë 202 “Studime e projekte” bazuar në inventarizimin mbi gjendjen fizike të studimeve dhe projekteve të financuara në vite në zbatim të kërkesave ligjore, si dhe të merren masat për plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor dhe regjistrimin në ZVRPP Tiranë të ndërtesave të saj.

Menjëherë

4.Gjetje: - Llog: 212, - Ndërtime dhe konstruksione të institucionit:

Kjo llogari nuk ka shtesa gjatë vitit 2017 dhe vlera është e barabartë me gjendjen në fillim të vitit në shumën prej 33,233,361 lekë, këto aktive janë krijuar që nga viti 2000 sipas procesverbalit datë 09.10.2000 të marrë nga Këshilli Rrethit Tiranë, por këto aktive nuk janë të regjistruara në ZVRPP, Tiranë (hipotekë), ndërsa inventarizimi i tyre është bërë sipas kontabilitetit.

Për këto objekte, janë hapur regjistra kontabël por të pa plotësuara me të gjitha të dhënat e nevojshme si, viti i krijimit të aseteve, amortizimi në vite, planimetritë dhe projektet e objektit ndërtimor etj., sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve

në njësitë e sektorit publik”, Kap. III. Këto objekte nuk janë të regjistrua në ZRPP Tiranë në pronësi të Këshillit të Qarkut dhe nuk është kryer inventarizimi fizik i tyre në vite në kundërshtim me kërkesat e neni 7 të ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar dhe pika 1, Kap. II e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

(Më hollësisht trajtuar në pikën B në faqet 17-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Të mëren masa për verifikimin e gjendjes fizike të aktiveve të qëndrueshme që administrohen nga Këshilli i Qarkut, me qëllim përcaktimin e statusit juridik të tyre dhe përgatitjen e dokumentacionit tekniko ligjor të nevojshme me qëllim regjistrimin e tyre në pronësi të Këshillit të Qarkut.

Brenda muajit Qershor 2019

5. Gjetje: Autoriteti kontraktor nuk i ka dorëzuar në Agjencinë e Prokurimit Publik Regjistrat e parashikimeve dhe të realizimeve të prokurimeve publike për vitet 2016, 2017, 2018 sipas afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore si: pikën 8 të Udhëzimit KM apo APP Nr. 2, date 27.01.2015, sipas nenit 4 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006

(Më hollësisht trajtuar në pikën A në faqet 20-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit). **5.1**

5.1Rekomandimi: Të analizohet arsyeja e vonesave të dorëzimit të Regjistrave të Parashikimit dhe Realizimit të Prokurimeve si dhe të marrën masa të plota për hartimin e dorëzimit të tyre sipas afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore, njëkohësisht të vlerësohet edhe dërgimi i regjistrave të ndryshimeve të prokurimeve në APP që ndodhin gjatë procesit të prokurimeve të fondeve.

Brenda vitit 2018

6. Gjetje: Për llogaritjen e fondit limit, Autoriteti kontraktor përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit për blerjen pajisjeve kompjuterike, goma autoveture, karburant etj., nuk i është referuar dhe dokumentuar asnjë alternativave të mëposhtëm: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); të përcaktuara në nenin 59 “Për llogaritja e vlerës limit të kontratë” të VKM Nr. 914, datë 27.12.2014,” Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime *(Më hollësisht trajtuar në pikën C në faqet 23-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandimi: Të merren masa që të mos nxirret Urdhri i Prokurimit nga Autoriteti kontraktor, pa llogaritur më parë fondin limit si dhe pa e dokumentuar dhe argumentuar atë ligjërisht duke ja bashkëlidhur këtë argumentim Urdhrit të Prokurimit.

Menjëherë

7. Gjetje: Me Urdhrin e Prokurimit Nr. 26, datë 7.09.2017 është aplikuar llogaritja e fondit limit me çmimet e tregut, kjo mënyrë nuk është i saktë, pasi në të përfshihet si tvsh-ja ashtu dhe fitimi *(Më hollësisht trajtuar në pikën C në faqet 46-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandimi: Në asnjë rast nuk duhet lejuar të llogaritet e fondin limit, mbi bazën e ofertave të paraqitura nga njësitë e shërbimit, gomisteri pasi nuk është e saktë, sepse në çmimin e gomave përfshihet dhe TVSh dhe fitimi, gjë që rezulton i rritur fondin limit i cili duhet të jetë i zhveshur nga TVSh dhe i mbështetur në specifikimet teknike që janë të përcaktuara për çdo tip mjeti sipa përcaktuara në nenin 59 “Për llogaritja e vlerës limit të kontratë” të VKM Nr. 914, datë 27.12.2014,” Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime

Menjëherë

8. Gjetje: Me urdhërin nr. 488, datë 23.03.2017 të Titullarit, është ngritur njësia e Prokurimit me kryetar një person që nuk është në organikën e Këshillit Qarkut por punon në një institucion tjetër, për funksionet që kryen përgjegjësi i njësisë prokurimit ai duhet të jetë punonjës i këtij institucioni jo me kontratë provizore si specialist inxhinier ndertimi. Personi/at përgjegjës për prokurimin duhet të administrojë/në në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimit. Në zbatim të ligjit të prokurimeve nr. 9643 (me ndryshimet) dhe nenit 57 të VKM nr. 914, datë 27.12.2014, titullari i autoriteti kontraktor cakton në përbërjen e njësisë së prokurimit, përveç personit përgjegjës për prokurimin, një ose disa persona të tjerë, me arsim të lartë (*Më hollësisht trajtuar në pikën C në faqet 47-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Titullari duhet të emërojë një punonjës përgjegjës për njësinë e prokurimit të këtij Institucioni, pasi nuk është kompetencë e Titullarit të emërojë një punonjës të një institucioni tjetër si përgjegjës për njësinë e prokurimit i cili duhet të jetë funksionar dhe të administrojë/në në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimit.

Brenda muajit dhjetor 2018

9. Gjetje: Në preventivin e objektit për “Sistemim, asfaltim të rrugëve të brendshme të lagjeve në fshatrat Pezë të Njësisë Administrative Pezë” konstatohet se për 4 zëra punimesh çmimet nuk i janë referuar çmimeve të manualit apo çmimit sipas analizës teknike, kjo ka sjellur rritjen e vlerës së preventivit, fondit limit (*Më hollësisht trajtuar në pikën C në faqet 23-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandim: Në asnjë rast të kryerjes së punimeve të ndërtimeve apo rikonstruksioneve nuk duhet të hartohet preventivi që aplikohet për llogaritjen e fondit limit pa aplikuar çmimet sipas manualit të ndërtimit të miratuar apo sipas analizës së çmimeve sipas manualeve të çmimeve të miratuara.

Në vazhdimësi

10. Gjetja: Urdhri Prokurimit me data 02.03.2018, është përcaktuar lloji i procedurës prokurimit në zbatim të Udhëzimit nr. 4, date 9.05.2017 “Krijimi i dosjes së tenderit për procedure pa lote, si dhe fond limit në vlerë 1,726,662 lekë me afat të realizimit 12 muaj nga data e lidhjes kontratës.

Konstatohet se llogaritja e fondit limit për objektin “Shërbimi i Ruajtjes me Roje Private i KQ Tiranë” nuk është kryer mbi bazën e parashikimeve ligjore në fuqi, për pagën baze reale për njësi për dy turne, referuar nenit 18, pika g, të ligjit nr 75/214 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” i cili përcakton që: paga bazë e personat juridik apo fizik Vendas apo të huaj të jetë 24,000 lekë, paga bazë të shërbimit të jetë 50 përqind me e madhe se paga minimale e përcaktuar me VKM nr. 399, date 03.05.2017 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, paga të jepet për 174 orë pune në muaj ose 21.75 ditë pune në muaj, duke zbritur ditë e pushimeve të shtunë të diele e ditë festash. Subjekti fitues “A..”SHPK që ka paraqitur ofertën me vlerë 1,689,515.65 lekë, nuk ka paraqitur ofertën për shërbimin që do kryente për dy turne faktikisht por për tre turne dhe për zëvendësues. Gjithashtu nuk është deklaruar dhe argumentuar paga neto mujore për çdo punonjës, pagesa e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që paguhet nga subjekti

(*Më hollësisht trajtuar në pikën C në faqet 25-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandimi: Të llogaritet fondi i pagës për njësi faktike për dy turne që kryejnë shërbimin sot, referuar nenit 18, pika g, të ligjit Nr. 75/214 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” dhe udhëzimit të APP për këtë shërbim sipas zbatimit faktik real, të përcaktohen shpenzimet e tjera dhe norma e fitimit, mbi këtë bazë të kryhet likuidimi i faturave mujore.

Menjëherë

11. Gjetje: Një mangësi që konstatohet dhe në hartimin e nevojave për punë, mallra ose shërbime është se fondet e vena në dispozicion janë shumë me tepër se fondet e shpenzuara, kjo tregon se planifikimi i përdorimit të fondeve është bërë formale, të pa studiuar dhe argumentuara saktë, nuk ka si justifikohet që në vitin 2016 për procedurat e prokurimit me “Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël” janë përdorur vetëm rreth 39 përqind të fondeve të vena në dispozicion, në 2017 për procedurat e prokurimit me “Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël” janë shpenzuar vetë 49 përqind të fondeve ndërsa në 9/mujorin e vitit 2018 janë shpenzuar 34 përqind e fondeve. Këto të dhëna flasin për përdorim tepër të ulet të fondeve të vena në dispozicion dhe për planifikim jo të saktë të fondeve që disponohen për realizimin sa më optimale të objektivave të përcaktuara (Më hollësisht trajtuar në pikën C në faqet 26-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Grupi i punës i ngritur për planifikimi i përdorimit të fondeve, të vihet para përgjegjësish për rastet e planifikimit fondeve jashtë mundësive dhe gjendjes reale të fondeve të venë në dispozicion.

Menjëherë

12. Gjetje: Në auditimin e dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme, konstatohet se nga Këshilli i Qarkut Tiranë, megjithëse është punuar në drejtim të zbatimit të tyre, akoma situata nuk është vlerësuar sa dhe si duhet, duke mos ndjekur deri në fund procedurat ligjore në zbatimin e rekomandimeve, kryesisht ato që kanë lidhje me shpërbllim dëmi, veprime në shkelje të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, dhe konkretisht masat e pa zbatuara janë:

Nga Drejtoria e Kordinim Zhvillimit (sektori i financës) në 6 raste nuk janë ngarkuar dhe arkëtuar detyrimet për shpërbllimin e dëmit në vlerën **717,353 lekë**, nga mos zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

(Më hollësisht trajtuar në pikën D në faqet 52-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Tiranë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërbllimin e dëmit në vlerën 717,353 lekë, nga punonjësit dhe ish-punonjësit dhe konkretisht:

- znj. M K.me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore në vlerën 61,632 lekë,
- znj. E D. me detyrë specialiste finance në Drejtorinë e Koordinim Zhvillimit në vlerën 251,983 lekë,
- znj. E L. me detyrë ish-specialiste për politikat sociale në vlerën 45,458 lekë dhe
- znj. E P. me detyrë ish-specialiste për arsimin dhe shëndetësinë në vlerën 48,458 lekë.
- z. K T. me detyrë ish-drejtues mjeti në vlerën 73,851 lekë,
- z. B M.me detyrë punonjës mbështetës i transportit dhe logjistikës në vlerën 29,589 lekë;
- Subjekti “B Sk ” për vlerën 35,914 lekë,
- subjekti “Z ” në vlerën 48,480 lekë dhe subjekti “K C ” për vlerën 81,600 lekë, si dhe të bëjë korrigjimin e rezultatin financiar të vitit 2015, për të njëjtën vlerë.
- znj. E M. me detyrë ish-specialist finance, në cilësinë e kryetarit të KBVV për vlerën 20,034 lekë,
- znj. G N. me detyrë ish-specialist për emergjencat civile, në cilësinë e anëtarit të KBVV për vlerën 20,033

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Për **punonjësit** të cilët aktualisht rezultojnë në marrëdhënie pune me Këshillin e Qarkut Tiranë, të cilët edhe pse janë identifikuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për disa të meta e mangësi që nuk i kapërcejnë kufijtë e shkeljes administrative, për arsye se asnjëra prej tyre gjatë përmbushjes së detyrave, nuk ka ndikuar negativisht apo ka sjellë pasojë të konsiderueshme në mirëfunksionimin e institucionit, konsiderojmë që për to të mos propozohet masë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R